



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG**

---

Numri i lëndës: 2022:109242

Datë: 09.09.2022

Numri i dokumentit: 03408064

**PPP.nr.23/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG**, si përmbarimore me Gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të kreditorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër debitorit L.A nga I.P K-Istog, me numër personal ..., për shkak të borxhit në shumë prej 100 €, pas prapësimit të ushtruar nga ana e debitorit, me dt: 13.04.2022 kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbarimit, gjykata jashtë seance me dt. 09.09.2022 nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**HEDHET POSHTË** prapësimi i debitorit L.A nga I.P K-Istog me numër personal ..., ushtruar kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.224/2022 të dt. 25.03.2022, sipas propozimit të kreditorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë për shkak të borxhit në shumë prej 100€, si i PA AFATSHËM.

**A r s y e t i m**

Kreditori, Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, ka ushtruar propozimin për përmbarim tek përmbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbarimi ndaj debitorit L.A nga I.P K-Istog me numër personal ..., si në shkresat e lëndës për borxh në shumë prej 100€ si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, të gjitha këto në afat 7 ditor nga dita e pranimit të urdhrorit, në të kundërtën të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm, bllokimi i llogarive bankare të debitorit, sekuestrimi regjistrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, e shuma e mjeteve të transferohet në llogari te kreditorit, të gjitha të specifikua në propozimin për përmbarim të datës 25.03.2022

Përmbaruesi privat me urdhrin e përmbarimit P.nr.224/2022 të dt.25.03.2022, e ka lejuar propozimin për përmbarim në këtë çështje përmbarimore.

Pas lejimit të përmbarimit me urdhër përmbarimor, të njëjtin përmbaruesi privat ja ka dorëzuar debitorit me datë 01.04.2022, me paralajmërimin se pala e pakënaqur ka të drejt të paraqes prapsim në afat 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit.

Debitori, L.A nga I.P K-Istog, ka ushtruar prapësim me shkrim me dt: 14.04.2022 kundër urdhrorit për përmbarim P.nr.224/2022 të dt.25.03.2022, me të cilën është lejuar përmbarim sipas propozimit të kreditorit: Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se debitori, nuk ka vepruar brenda afatit ligjor të përcaktuar për paraqitjen e prapsmit kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, andaj gjykata, bazuar në nenin 70 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore i cili thotë citoi “Prapësimi duhet të paraqitet gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues” e në rastin konkret debitori L.A nga I.P K-Istog, e ka pranuar propozimin për përmbarim të lejuar me urdhër me datë 01.04.2022 dhe afati ka filluar të ecë nga data 02.04.2022, ndërsa prapësimin e ka ngritur me datë 14.04.2022, e nga pranimi i propozimit të përmbarimit të lejuar me urdhër përmbarimor e deri me ditën e paraqitjes së prapësimit kanë kaluar 13 ditë, e në rastin konkret afati i fundit për ngritjen e prapësimit ka qenë data 08.04.2022, ashtu që prapësimi i debitorit konsiderohet si I PA AFATSHËM.

Andaj, nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 70, 73.3 të LPP-së (Ligjit të Procedurës Përmbarimore), u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG**  
**PPP.nr.23/2022, dt. 09.09.2022**

**GJYQTARI**  
Blerim Istrefi

**UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.